




B4STUDENTS

2022

**BUSINESS
CHALLENGE
COMPETITION
EDITION 2**

Vazhdo ta sfidosh veten për të menduar më mirë, për të bërë më mirë dhe për të qenë më i mirë.

Robin Sharma

PËRMBAJTJA

03 B4Students

04 Rreth Business Challenge Competition

05 Prezantimi i Sfidës së Biznesit

07 Letër nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv

08 Tirana Bank

B4STUDENTS

B4Students është program i dedikuar për studentët në Shqipëri me fokus zhvillimin profesional, punësimin dhe vetëpunësimin e tyre, me mbështetjen e Grupit BALFIN.




Programi u prezantua për publikun në vitin 2021. Regjistrimi i studentëve në program është i mundur në çdo moment përmes plotësimit të formularit online në linkun:

bit.ly/iamb4students

RRETH BUSINESS CHALLENGE COMPETITION

Konkursi i Sfidave të Biznesit, organizuar nga programi B4Students, në bashkëpunim me kompani të Grupit BALFIN, është një aktivitet i dedikuar për studentët të cilët konkurrojnë për të krijuar e prezantuar zgjidhjen më të mirë për një sfidë reale biznesi.

Synimi kryesor i këtij aktiviteti është të nxisë dhe mbështesë rritjen profesionale të studentëve në Shqipëri të cilët duan të testojnë dhe zhvillojnë aftësitë e tyre në analizën e problemeve të biznesit dhe menaxhimin strategjik, në rrethana konkrete.



DATA TË RËNDËSISHME

- 6 shtator 2022 | afati për regjistrim dhe dërgimin e zgjidhjes
- 7 shtator 2022 | vlerësimi i zgjidhjeve dhe përzgjedhja e finalistëve
- 8 shtator 2022 | prezantimi i zgjidhjeve dhe përzgjedhja e tre fituesve

Në formulimin e zgjidhjes inkurajohet të jeni krijues. Kujdes! Një strategji e mirë duhet të jetë në përputhje me natyrën e kompanisë dhe të balancojë vlefshmërinë financiare me përgjegjësinë e qëndrueshmërinë.

KRITERET E VLERËSIMIT

- Kreativiteti i zgjidhjes
- Dobishmëria e zgjidhjes
- Zbatueshmëria e zgjidhjes
- Detajimi i zgjidhjes

ÇMIMET PËR FITUESIT

- Shpërblim monetar (sipas renditjes: 1 - 300 €; 2 - 250 €; 3 - 200 €)
- Kurs trajnimi online falas me përzgjedhje nga studenti (Coursea, etj)
- Ofertë për praktikë profesionale me mundësi punësimi në Tirana Bank

SFIDA E TIRANA BANK

Covid-19 dhe zhvillimet teknologjike kanë ndikuar ndjeshëm në qëndrimet e gjeneratës më të madhe në botë, "Gen Z" (të lindurit midis vitit 1996 dhe 2010) ndaj financave. Mënyra se si ata mendojnë dhe veprojnë në lidhje me paratë tani mbetet një sfidë për të gjithë industrinë bankare, në përpjekje për të kuptuar dhe reaguar sa më shpejt me produkte dhe shërbime të dedikuara, në përputhje me pritshmëritë dhe zakonet e tyre.

Tirana Bank, mbështetur në strategjinë e zhvillimit si dhe në politikat për përgjegjëshmëri sociale, ka qenë gjithmonë e angazhuar për të krijuar e mundësuar zgjidhje sa më të përshtatshme për plotësimin e nevojave të të rinjve në Shqipëri, për produkte bankare dhe eksperiencë konsumatore sa më të kënaqshme. E fokusuar drejt përmirësimit të vazhdueshëm, **Tirana Bank fton studentët të propozojnë zgjidhjet e tyre për një bankë më të orientuar dhe në mbështetje të pritshmërive të të rinjve në Shqipëri.**

Studenti, sipas preferencës mund të trajtojë një ose disa nga nënsfidat e mëposhtme:

- 1 Cilat janë investimet, facilitetet dhe shërbimet e reja që duhet të ofrohen nga Tirana Bank që përmirësojnë eksperiencën bankare të të rinjve?
- 2 Në vlerësimin tuaj, çfarë i inkurajon më tepër të rinjtë në Shqipëri gjatë vendimarrjes për të përzgjedhur një institucion financiar / bankë?
- 3 Në mbështetje të përmirësimit të jetës sociale-kulturore të të rinjve, cilat do të ishin aktivitetet e qëndrueshme që duhen mbështetur nga Tirana Bank?
- 4 Në vizionin tuaj, çfarë mund të bëhet më tepër nga Tirana Bank për një produkt/ shërbim digjital më tërheqës dhe të kuptueshëm nga të rinjtë?
- 5 Për të përmbushur sa më mirë pritshmëritë e të rinjve në Shqipëri mbi veçoritë e produktit bankar, cilat do të ishin sugjerimet tuaja?



LETËR NGA DREJTORI I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Të dashur studentë,

Kam kënaqësinë të njoftoj se Tirana Bank është përzgjedhur për edicionin e dytë të Konkursit të Sfidave të Biznesit, organizuar nga Grupi BALFIN nëpërmjet programit B4Students.

Themeluar në vitin 1996, e njohur si banka e parë private në Shqipëri, Tirana Bank është gjithmonë e orientuar drejt plotësimit të nevojave të klientëve, përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit dhe ideve të reja, duke u pozicionuar si një nga institucionet financiare më dinamike në tregun lokal.

Ju ftojme të bëheni pjesë e përpjekjeve tona për të sjellë Bankën sa më afër nevojave të grupmoshës tuaj, në shumëllojshmëri të produkteve bankare, risi në shërbime digjitale, si dhe në forma të ndërveprimit e komunikimit, për një eksperiencë sa më të përkushtuar dhe miqësore.

Platforma digjitale inovative TiBank, Karta e Kreditit Visa Classic Co-Branded në bashkëpunim me programin e besnikërisë HAPPY, si dhe investimet në teknologji, janë vetëm disa nga angazhimet tona aktuale në drejtim të përmirësimit të shërbimit bankar, me fokus kryesisht grupmoshën tuaj.

Tirana Bank është e vendosur për të vlerësuar ide të reja dhe zgjidhje inovative, për të mundësuar plotësimin e kërkesave në rritje të klientëve si dhe zgjerimin e aktivitetit bankar.

Faleminderit për kohën dhe punën tuaj!

Përshendetje,

Dritan Mustafa

RRETH TIRANA BANK

Tirana Bank është banka e parë me kapital tërësisht privat në Shqipëri, themeluar në vitin 1996. Gjatë kësaj periudhe Banka ka realizuar një zhvillim të shpejtë në tregun lokal, duke shtrirë degët në të gjithë Shqipërinë, me prezencë të konsoliduar në treg dhe duke ofruar një gamë të gjerë produktesh dhe shërbimesh, që u përgjigjen me së miri kërkesave të klientëve.

Tirana Bank është pjesë e Grupit BALFIN dhe operon në bashkërendim me objektivat dhe synimet e Grupit, për të qenë lider në ofrimin e shërbimeve financiare. Banka vijon të zgjeroj aktivitetin, duke ruajtur me rigorozitet filozofinë për ofrimin e shërbimeve cilësore.

Referuar kërkesave të klientëve të grupmoshës tuaj, Tirana Bank ofron shërbime inovative produkte, për të cilat gjeni detaje si më poshtë.

KREDIA DHE PAKETA STUDENTORE

Kredia Studentore ofron financim deri në 100% të faturës së tarifës së studimit, brenda dhe jashtë vendit, me kredi të pasiguruar (deri në vlerën 1,250,000 lekë dhe kohëzgjatje deri në 7 vjet), apo kredi të siguruar me pronë (deri në vlerën 6,250,000 lekë dhe kohëzgjatje deri në 15 vjet), me terma preferencialë, dhe kryerjen e pagesës së principalit dhe interesit me këste të barabarta mujore.

Paketa Studentore është një mundësi tjetër nga Tirana Bank, e dedikuar 100% për studentët, me terma preferenciale, e përbërë nga:

i. Llogaria Studentore, ii. Karta e Debitit Visa ne LEK & EURO, iii. Shërbime Transfertash, dhe iv. Platforma TiBank. Produktet dhe shërbimet e Paketës Studentore mundësohen me kushte preferenciale.

APLIKACIONI TIBANK

Tibank, platforma online e Tirana Bank, mundëson për përdoruesit një gamë të gjerë të veprimeve bankare, me sigurinë më të lartë të teknologjisë elektronike, nëpërmjet internetit, nga ekrani i celularit apo/dhe i kompjuterit, kudo dhe gjatë gjithë kohës.

Nëpërmjet TiBank, përdoruesit kanë mundësi të : verifikojnë balancën dhe lëvizjet e llogarisë, të kryejnë urdhërpagesat periodike, verifikojnë gjëndjen e kartave personale të debitit dhe kreditit, të monitorojnë kreditë konsumatore dhe kreditë për shtëpi (diferenca për t'u paguar, datat e pagesave, shuma e kësteve), krijojnë një depozitë të re dhe të ndjekin ecurinë e saj.

Në mënyrë sa më praktike, pa qënë nevoja për t'u paraqitur në degë, përdoruesit e TiBank mund të kryejnë pagesa të kartës së kreditit, kësteve të kredisë apo faturave të shpenzimeve utilitare (telefoni celulare, drita dhe ujë) apo transferta midis llogarive personale, në çdo llogari të Tirana Bank, si dhe në në çdo bankë brenda dhe jashtë Shqipërisë.

KARTA E KREDITIT VISA CLASSIC CO-BRANDED

Karta e Kreditit Visa Classic Co-Branded është një limit kredie i aprovuar deri në 3 përfitues/kartë mbajtës të lidhur me një llogari. Ofrohet në monedhën lekë ose Euro dhe mundëson kryerjen e pagesave të shpejta dhe të sigurta, edhe me këste nga 2 deri në 12 muaj në pikat e shitjes POS të Tirana Bank.

Perfitoni : 0 komision për blerjet në të gjithë botën, shërbimin e njoftimit falas përmes SMS / Email Alert për transaksionet e kryera , si edhe faturën mujore . Karta e kreditit Visa Co-branded , ne nje perdorim me teknologjinë Chip dhe pa kontakt.

Karta ofrohet në bashkëpunim me programin më të madh të besnikërisë në Shqipëri, HAPPY. Nga ky bashkëpunim, përdoruesit e kartës përfitojnë dy-fish pikë në çdo blerje në rrjetin Spar, Jumbo, FGA dhe Neptun, pjesë e Grupit BALFIN, kupon extra me vlerën 500 lekë për çdo nivel pikësh të arritura nga klienti, oferta të personalizuar për blerjet tuaja, si dhe pikë bonus për evente speciale.

BURIME PËR INFORMACION

- www.tiranabank.al dhe www.balfin.al
 - Raportet Vjetore dhe publikime të tjera të Tirana Bank / online
 - Intervistat e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Bordit Drejtues / online
-



www.b4students.com | hello@b4students.com



Informacioni i prezantuar në këtë material është përgjegjësi e programit B4Students. Materiali është përgatitur në funksion të Konkursit të Sfidave të Biznesit dhe nuk mund të përdoret si referencë dhe të publikohet nga palë të tjera, pa aprovim paraprak.